

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Menaxhmentit
Programi:	Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia
Titulli i lëndës:	Lidershipi
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III
Semestri:	VI
Numri orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	UShAF
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Prezantimi i lëndës, Hyrje në çështjet e Lidershipit, Kuptimi i Lidershipit, Lidershipi dhe menaxhimi, Lidershipi dhe qeverisja, Përkufizimi, definimi dhe rëndësia e Lidershipit, Lidershipi dhe autoriteti, Dija dhe autoriteti, Zhvillimi i personalitetit si faktor për Lidershipin, Karakteristikat cilësore dhe stilet e Lidershipit, Teoritë e Lidershipit të shekullit XX, Roli i motivimit në lireship, Roli dhe rëndësia e Lidershipit, A është Etika një dimension për Lidershipin, Komunikimi si element kyç për Lidershipin, Lidershipi me vizion, Puna në ekip si bazë për Lidership, Lidershipi ekipor, Ekipet në ekonominë kreative dhe koeficienti i vitalitetit, Roli i drejtuesit të ekipit, Lidershipi në praktikë, Raste studimore, Shembuj dhe detyra praktike,
Qëllimet e lëndës	Ky kurs është krijuar për të ofruar një hyrje bazë të lidërsipit duke u fokusuar në atë që do të thotë të jesh një Lider i mirë. Qëllimi i kësaj lënde është të përgatisë menaxherët e ardhshëm për të krijuar dhe kultivuar vlerat e lidërsipit, në mënyrë që të ballafaqohen me sfidat e të ardhmes, duke njohur dallimet dhe të përbashkëtat në mes të liderit dhe menaxher dhe duke zhvilluar dhe kultivuar aftësitë e liderit në biznes, për të arritur qëllimet individuale, grupe dhe të biznesit.
Rezultatet e pritura të mësim-nxënies	Pas përfundimit të suksesshëm të modulit, studenti duhet të: 1. Kuptoj mënyrën se si praktikohet Lidershipi në biznese, (ECTS:1), 2. Interpretoj praktikat përkatëse themelore të Lidershipit për bizneset bashkëkohore, (ECTS:0.5), 3. Njohe problemet dhe mundësitë organizative, menaxheriale dhe drejtuese në ndërmarrje. (ECTS:0.5), 4. Kuptojë dhe analizojnë ndikimin e Inteligjencës Artificiale në lidërsip, duke identifikuar mënyrat se si IA transformon vendimmarrjen, menaxhimin e ekipeve dhe zhvillimin e kompetencave të liderëve në epokën digjitale., (ECTS:1), 5. Vlerësojë potencialin e filozofisë së Lidershipit mbi tiparet, aftësitë, sjelljet dhe do të zhvillojnë një portofol Lidershipi, (ECTS:0.5),

	6. Zhvilloj aftësitë ndërpersonale, zhvillimin e ekipit, menaxhimin e konflikteve, aftësitë e komunikimit dhe ndryshimit, (ECTS:0.5),		
	7. Identifikoj stilet e Lidershipit te përshtatshme për ndërmarrjen, , (ECTS:0.5),		
	8. Të zgjerojë aftësitë e tyre duke krahasuar qasjet e ndryshme të Lidershipit. , (ECTS:0.5),		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/detyra	1	15	15
Punë praktike	5	1	5
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet	1	5	5
Përgatitja për detyra projekte	1	5	5
Projekt kursi - Test (planifikim + zbatim)	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			35
Përgatitja përfundimtare në provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	3	2	6
Projektet, prezantimet etj	1	5	5
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies dhe mësim-nxënies	Studimi të cilat do të diskutohen në grup, mësimi duke u bazuar në një problem/shans të paraqitur, luajtja e roleve, mësimet praktike për lëndën dhe angazhim për studentin për të prezantuar njohurit e fituara përmes rasteve studimore, punimeve seminarike, apo/ dhe hulumtimeve, zgjidhjes së detyrave numerike dhe interpretimit të tyre..		
Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë	<u>Metoda e vlerësimit</u> – mbështetet në tri aktivitete – në bazë të cilave do të ndërtohet nota përfundimtare: ➤ Aktivitetet dhe Angazhim në mësim.....max 15 pikë (%), ➤ Prezantimi i projektit/punim seminarik.....max 15 pikë (%), ➤ Provimi final (ose nga dy teste).....max 70 pikë (%), <u>Kriteret e kalueshmërisë:</u> 1. Aktiviteti dhe Angazhimi në mësim – vlerësohet me 15 pikë (%) nga 100 pikët (%)e mundshme: • Aktiviteti në mësim (8 pikë (%)) - nënkupton që studenti të jetë aktive dhe i përfshirë në diskutime interaktive profesor-studentë, studentë-studentë, duke hapur tema të reja që janë të ndërlidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim të nxitjes së debatit gjatë ligjëratave. • Angazhimi (7 pikë (%)) - nënkupton që studenti të kryejë dhe prezantojë detyrat që caktohen në fund të secilës ligjëratë dhe pastaj		

diskutohen në fillim të ligjërates vijuese.

Qëllimi: Nxitja e mendimit kritik dhe zgjidhja kreative e situatave reale ndërlidhur me problemet e parashtruara - te ndërlidhura me mësim-nxënien në modulin e lëndës.

2. Hartimi dhe prezantimi i një projekti/punimi seminari - vlerësohet me 15 pikë nga 100 pikët (%) e mundshme,

Brenda semestrit studenti (mund të jetë një grup i studenteve – jo me shume se 3 studentë) duhet të përgatit një projekt/punim seminari (Word dhe në PowerPoint), i njëjti punim duhet të prezantohet gjatë orëve të caktuara për prezantim. Prezantimi do të zgjasë më së shumti 15 minuta.

Tema e punimit mund të propozohet nga profesori dhe nga studenti – tema e propozuar nga studenti duhet të miratohet nga profesori, dhe e njëjta duhet të jetë në korrelacion të plot me lëndën.

Punimi prezantohet para grupit dhe vlerësohet në bazë të cilësisë së përmbajtjes, analizës, kreativitetit dhe aftësisë për ta prezantuar qartë.

Kriteret e vlerësimit të projektit/punimit seminari	
Komponenti	Pikët (%)
Struktura dhe Qëllimi i punimit	4
Përmbajtja/shtjellimi i punimit	6
Përfundimet e nxjerra dhe prezantimi i punimit	5
Gjithsej:	15

Qëllimi: zhvillimi i aftësive kërkimore, analitike dhe shkencore, përmes trajtimit të një teme të caktuar në mënyrë të pavarur dhe akademike - te ndërlidhura me mësim-nxënien në modulin e lëndës.

3. Testi i provimit final, vlerësohet me 70 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme,

Brenda semestrit parashihet të mbahen dy Teste (2 x 35 pikë (%)) për studentët e angazhuar aktiv me pjesëmarrje në ligjërata, testi i parë në javën e 7 ose të 8 dhe testi i dytë në fund të ligjëratave, studenti e kalon testin nëse ka min. 18 pikë (%), pasi që studenti vlerësohet se ka kaluar testin e parë, atëherë studenti mund t'i nënshtrohet testit të dytë, studenti ka të drejtë të nënshtrohet drejtpërdrejt provimit final - me gojë ose me shkrim. Studenti do t'i nënshtrohet testit të provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe në afatet e provimeve të përcaktuara nga senati i Universitetit.

Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet të plotësohet në mënyrë individuale nga studenti dhe i njëjti vlerësohet sipas kriterëve dhe përmban:

- ♦ pyetje objektive me zgjedhje të shumëfishta alternative, të njëjtat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të ri- kujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës.....**30 pikë (%)**
- ♦ pyetje subjektive të llojit tema për shpjegim/përgjigje me shkrim/detyra - për të cilat vet studenti duhet të jete në gjendje të jep përgjigje ndërlidhur me materialin e lëndës së ligjëruar, të njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e

	fituara në analizë, sintezë/vlerësim të problemit.....40 pikë (%) Qëllimi i testit: të vlerësojë përvetësimin e rezultateve të mësimit – nxënies dhe aftësinë për t'i zbatuar ato në situata praktike. Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë (%) nga të gjitha aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit, Notat në UShAF: <table><tr><th>Nota</th><th>ECTS/Nota</th><th>Përqindja (%)</th><th>Përkufizimi</th></tr><tr><td>10</td><td>A</td><td>90 - 100</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>9</td><td>B</td><td>80 - 89</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>8</td><td>C</td><td>70 - 79</td><td>Shumë mirë</td></tr><tr><td>7</td><td>D</td><td>60 - 69</td><td>Mirë</td></tr><tr><td>6</td><td>E</td><td>50 - 59</td><td>Mjaftueshëm</td></tr><tr><td>5</td><td>FX/F</td><td>0 - 49</td><td>Pamjaftueshëm</td></tr></table>	Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi	10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm	9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm	8	C	70 - 79	Shumë mirë	7	D	60 - 69	Mirë	6	E	50 - 59	Mjaftueshëm	5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm
Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi																										
10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm																										
9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm																										
8	C	70 - 79	Shumë mirë																										
7	D	60 - 69	Mirë																										
6	E	50 - 59	Mjaftueshëm																										
5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm																										
Mjetet e konkretizimit – TI	Përdorimi i Smart-tabelës, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, Përdorimi i platformave dhe mjeteve “on-line” për të mbështetur komunikimin dhe bashkëpunimin në ekip, etj.																												
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	70% - Teori, 30% - Ushtrime praktike, Ky raport ka për qëllim të analizojë lidhjen ndërmjet njohurive teorike të përfituara gjatë ligjëratave të parapara në modulën e lëndës dhe realizimit të ushtrimeve praktike (vizita praktike, ushtrime me studente, kuize studentore në klase, etj) Nga gjithsej 125 orë të parapara për lëndën, ndarja është bërë sipas raportit 70% me fokus në teori dhe 30% në praktikë. • 88 orë janë të dedikuara për ligjëratat teorike, përfshirë përvetësimin e koncepteve bazë, metodologjive dhe standardeve të parapara në modulën e lëndës. • 37 orë janë të fokusuar në ushtrime praktike, vizita pune, analiza rastesh konkrete, punë në grup dhe zhvillim projektesh simulimi. Ndarja e 5 ECTS: ❖ 3.5 ECTS i dedikohen pjesës teorike ❖ 1.5 ECTS i dedikohen pjesës praktike. Kjo ndarje reflekton balancën ndërmjet përvetësimit të koncepteve bazë dhe zbatimit të tyre përmes aktiviteteve praktike.																												
Literatura																													
Literatura bazë	1. Enver Krasniqi, Vasilika Kume, Nazmi Mustafa, (2019). Liderhipi – teori, koncepte dhe praktika, botimi i dytë, TIMEGATE, Prishtinë 2. Anja Ebert-Steinhübel, (2021), Learning Leadership - Führung lebenslang neu lernen, Springer Fachmedien Wiesbaden GmbH,																												
Literatura shtesë	1. Berim Ramosaj, (2017), Leadership, Dukagjini. Pejë 2. Theo Peters, (2015), Leadership Traditionelle und moderne Konzepte - Mit vielen Beispielen, Springer Fachmedien Wiesbaden 3. David Borkowski(2025)"The Intelligent Leader: Embracing AI to Transform Your Leadership",																												
Informacion shtesë –	*Punimi Shkencor - nga autori: Gazmend Deda *, Arben Tërstena **,																												

Punimi Shkencor nga profesori i lëndës:	Sokol Krasniqi *, Stela Todorova, me titull “Evaluation of influence of corruption, lending interest rate and other components on ease of doing business: A policy-making and legal implications.” 2024 / Volume 6, Issue 3, 8–16. Linku i punimit: https://virtusinterpress.org/IMG/pdf/clgrv6i3p1.pdf
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	Prezantimi i lëndës Hyrje në çështjet e Lidershipit. Ligjërata mbi hyrjen në çështjet e lidershipit fokusohet në konceptet themelore të udhëheqjes, duke trajtuar dallimin mes lidershipit dhe menaxhimit, rolin e vizionit dhe misionit në procesin udhëheqës, stilet kryesore të lidershipit dhe ndikimin e tyre në motivimin e individëve dhe performancën e organizatës. Rezultati i pritur, Nr.1,
Java e dytë	Kuptimi i Lidershipit, Lidershipi dhe menaxhimi, Lidershipi dhe qeverisja. Lidershipi nënkupton procesin e ndikimit tek individët apo grupet për të arritur qëllime të përbashkëta. Ai lidhet me aftësinë për të krijuar vizion, për të frymëzuar dhe për të udhëhequr ndryshime. Edhe pse shpesh përdoren si sinonime, lidershipi dhe menaxhimi kanë dallime thelbësore: menaxhimi fokusohet tek planifikimi, organizimi dhe kontrolli i burimeve për të arritur efikasitet, ndërsa lidershipi lidhet me frymëzimin, motivimin dhe krijimin e vizionit për të ardhmen Rezultati i pritur, Nr.1,2
Java e tretë	Transformimi i Lidershipit në Epokën e Inteligjencës Artificiale. Në këtë ligjëratë do të diskutohet sesi Inteligjenca Artificiale po transformon lidershipin, duke ndryshuar mënyrën e vendimmarrjes, menaxhimit të ekipeve dhe zhvillimit të strategjive organizative. Do të shqyrtohen përfitimet, sfidat dhe praktikat më të mira për integrimin e IA në rolin e liderit modern. Rezultati i pritur, Nr.4,1
Java e katërt	Lidershipi Inteligjent: Roli i Inteligjencës Artificiale në Zhvillimin e Kompetencave të Liderëve, Në këtë ligjëratë do të shqyrtohet sesi Inteligjenca Artificiale mund të fuqizojë zhvillimin e kompetencave të liderëve, përmes trajnimeve virtuale, analizës së të dhënave dhe feedback-ut në kohë reale. Do të diskutohet ndikimi i IA në përmirësimin e vendimmarrjes, komunikimit dhe menaxhimit të ekipeve në epokën digjitale. Rezultati i pritur, Nr.4
Java e pestë	Teoritë e Lidershipit të shekullit XX, Në ligjëratën mbi teoritë e lidershipit të shekullit XX trajtohen qasjet kryesore që kanë ndikuar zhvillimin e shkencës së udhëheqjes. Fillimisht analizohet teoria e tipareve (trait theory), e cila lidhet me karakteristikat e lindura të liderëve; më pas teoritë e sjelljes (behavioral theories), që

	fokusohen tek veprimet dhe mënyra se si liderët ndërveprojnë me ndjekësit. Rezultati i pritur,Nr.5,4
Java e gjashtë	Roli i motivimit në lireship, Kjo ligjëratë trajton ndikimin e motivimit si forcë shtytëse që nxit liderët të frymëzojnë, angazhojnë dhe orientojnë ndjekësit drejt arritjes së objektivave të përbashkëta. Rezultati i pritur,Nr.6
Java e shtatë	Roli dhe rëndësia e Lidershipit, Kjo ligjëratë trajton rolin dhe rëndësinë e lidershypit në drejtimin e njerëzve, krijimin e vizionit dhe arritjen e suksesit organizativ. Rezultati i pritur,Nr.7,
Java e tetë	A është Etika një dimension për Lidershipin, Dikutohet se , etika është një dimension thelbësor i lidershypit, sepse përcakton mënyrën se si liderët marrin vendime dhe ushtrojnë autoritetin e tyre. Një lidershyp etik ndërton besim, transparencë dhe përgjegjësi në organizatë. Rezultati i pritur,Nr.5,3
Java e nëntë	Komunikimi si element kyç për Lidershipin, Kjo ligjëratë trajton komunikimin si element kyç të lidershypit, duke theksuar rëndësinë e shkëmbimit efektiv të informacionit dhe aftësisë për të frymëzuar dhe udhëhequr ndjekësit. Komunikimi i mirë ndihmon në ndërtimin e besimit, zgjidhjen e konflikteve dhe arritjen e qëllimeve organizative. Rezultati i pritur,Nr.5
Java e dhjetë	Lidershipi me vizion, Në këtë ligjëratë diskutohet rëndësia e vizionit në lidershyp, duke u fokusuar tek aftësia e liderit për të përcaktuar qëllime afatgjata, për të frymëzuar ndjekësit dhe për të orientuar organizatën drejt suksesit dhe ndryshimeve pozitive. Rezultati i pritur,Nr.4,5
Java e njëmbëdhjetë	Puna në ekip si bazë për Lidership, Kjo ligjëratë trajton punën në ekip si bazë për lidershypin, duke theksuar se aftësia për të bashkëpunuar, ndarë përgjegjësi dhe për të koordinuar veprimet e anëtarëve është thelbësore për arritjen e objektivave të përbashkëta dhe për zhvillimin e një lidershypit efektiv. Rezultati i pritur,Nr.5,7,4
Java e dymbëdhjetë	Lidershipi ekipor, Kjo ligjëratë trajton lidershypin ekipor, duke u fokusuar tek aftësia e liderit për të udhëhequr grupin, për të koordinuar rolet dhe përgjegjësitë e anëtarëve, dhe për të nxitur bashkëpunimin dhe performancën e përbashkët drejt arritjes së objektivave. Rezultati i pritur,Nr.5,6
Java e trembëdhjetë	Ekipet në ekonominë kreative dhe koeficienti i vitalitetit Roli i drejtuesit të ekipit, Kjo ligjëratë trajton rolin e ekipeve në sektorët kreativë, ku inovacioni dhe fleksibiliteti janë thelbësore, dhe diskuton koeficientin e vitalitetit si tregues të energjisë, angazhimit dhe produktivitetit të ekipit. Ligjërata thekson rëndësinë e drejtuesit në motivimin, koordinimin dhe mbështetjen e ekipit, duke siguruar një mjedis që nxit bashkëpunimin, inovacionin dhe arritjen e objektivave të përbashkëta. Rezultati i pritur,Nr.5,4,7,8
Java e katërbëdhjetë	Lidershipi në praktikë, (ligjerat nga punimi shkencore) “Vlerësimi i ndikimit të korrupsionit, normave të interesit të huadhënies dhe faktorëve të tjerë në lehtësinë e të bërit biznes:

	Implikimet për politikëbërjen dhe aspektet ligjore, Në këtë ligjëratë, e cila bazohet në punimin shkencor “Vlerësimi i ndikimit të korrupsionit, normave të interesit të huadhënies dhe faktorëve të tjerë në lehtësinë e të bërit biznes: Implikimet për politikëbërjen dhe aspektet ligjore”, trajtohet mënyra se si liderët në sektorin publik dhe privat mund të ndikojnë në krijimin e një mjedisi të favorshëm për biznes. Diskutohet roli i leadershipit në luftën kundër korrupsionit, menaxhimin e normave financiare dhe vendimmarrjen strategjike që ndikon në lehtësinë e të bërit biznes, duke nxjerrë mësim praktikë për politikëbërësit dhe drejtuesit ligjorë. Rezultati i pritur,Nr.7,3
Java e pesëmbëdhjetë	Prezentimi i punimeve seminarike dhe/ose Hulumtimeve, Në këtë ligjëratë trajtohet rëndësia e prezantimit të punimeve seminarike dhe hulumtimeve shkencore si mjet për zhvillimin e aftësive analitike dhe komunikative të studentëve. Diskutohet mënyra e strukturuar e prezantimit, përfshirë organizimin e përmbajtjes, përdorimin e vizualizimeve, argumentimin e rezultateve dhe përgjigjen ndaj pyetjeve, duke nxitur aftësinë për të komunikuar me qartësi dhe për të mbrojtur gjetjet shkencore para një audience.
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte ndaj kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësimdhënësi ka të drejtë t'i kërkojë studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.	